

Kampionët e Ndryshimit **(Champions of Change)**

1. Qëllimi dhe roli i “Kampionëve të Ndryshimit”

Bashkitë janë aktorë kyç në ndërgjegjësimin e publikut dhe komunikimin e krizave për shkak të mandatit të tyre ligjor dhe afërsisë me qytetarët.

Projekti “REAGO” parashikon përzgjedhjen e gjashtë (6) bashkive/prefekturave si “Kampionë të Ndryshimit”.

Bashkitë dhe prefekturat e përzgjedhura në fazën fillestare do të konkurojnë midis tyre për të krijuar dhe zbatuar praktikën më të mirë, dhe në fazën finale të pilotimit do të përzgjidhet 1 bashki dhe 1 prefekturë fituese.

Bashkia fituese do të shpërblehet me një grant prej 5,000 eurosh, ndërsa prefektura fituese me një grant prej 2,000 eurosh.

Pjesëmarrësit do të duhet të:

- Jenë aktivë në të gjitha fazat e zhvillimit të Kuadrit Strategjik, kryesisht në Tiranë.
- Kontribuojnë në testimin dhe vlerësimin e udhëzuesve, mjeteve dhe materialeve të zhvilluara në kuadër të këtij komponenti, kryesisht në nivel lokal.
- Angazhohen në fazën pilote të aktiviteteve të përzgjedhura, me fokus rritjen e Ndërgjegjësimit Publik dhe Komunikimit të Krizave në Shqipëri.

Këto aktivitete janë parashikuar kryesisht gjatë vitet 2027-2028, në nivel lokal dhe/ose rajonal.

2. Përfitimet që kanë “Kampionët e Ndryshimit”.

1. **Ndikim direkt në Strategjinë Kombëtare:** Mundësia për të bashkë-projektuar Strategjinë Kombëtare për Ndërgjegjësimin dhe Gatishmërinë e Publikut, dhe Komunikimin e Krizave (përfshirë udhëzuesit dhe mjetet për nivelet kombëtare, rajonale dhe lokale).
2. **Ngritja e kapaciteteve dhe ekspertizës:** Akses në trajnime të synuara, sesione "Trajnim për Trajnerët" (ToT) dhe ushtrime praktike.

3. **Akses i hershëm në pilotime dhe mjete:** Zbatimi i parë i metodave të reja, modeleve (templates) dhe mjeteve digjitale/analoge.
4. **Dukshmëri dhe njohje:** Profilizimi zyrtar si "Kampion i Ndryshimit" në komunikimet e projektit REAGO.
5. **Rrjetëzim dhe mësim nga njëri-tjetri:** Forume të strukturuar me bashki dhe prefektura të tjera, si dhe një mundësi potenciale për një vizitë studimore në Suedi (në varësi të fondeve të disponueshme të BE-së).
6. **Përmirësimi i gatishmërisë dhe rimëkëmbjes nga krizat:** Forcimi i proceseve lokale/rajonale për komunikimin e rrezikut dhe përdorimi i metodave gjithëpërfshirëse (përfshirë grupet e rrezikuara dhe çështjet gjinore).
7. **Akses dhe mbështetje:** Akses në lista kontrolli (checklists) dhe udhëzime për integrimin e aktiviteteve për qeverisjen e mire.
8. **Mbështetje financiare:** Grant prej 5,000-euro (për bashkinë fituese) dhe 2,000 euro (për prefekturën fituese), për të zbatuar një projekt lokal për ndërgjegjësimin e komunitetit.

3. Kriteret e përzgjedhjes

1. **Statusi Administrativ:** Bashki ose prefekturë në Shqipëri.
2. **Ekipi i dedikuar:** 2 deri në 6 anëtarë të stafit të bashkisë/prefekturës të angazhuar dhe që do jenë pjesëmarrës në takimet dhe trajnimet që do të zhvillohen në Tiranë (2026–2028). Inkurajohet balanca gjinore.
3. **Miratim nga drejtuesi i institucionit:** Letër angazhimi e nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë/Prefekti që konfirmon pjesëmarrjen, stafin që do përfshihet dhe marrjen përsipër të kostove të tyre.
4. **Etika dhe Qeverisja e mirë:** Pajtueshmëria me parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit.

Kriteret Teknike dhe programatike

1. **Profili i rrezikut:** Zona aktive sizmike, ose të prirura ndaj zjarreve në pyje, përmbytjeve dhe rrëshqitjeve të dherave.
2. **Kapaciteti institucional:** Ekzistenca e pikave fokale për mbrojtjen civile ose komunikimin.
3. **Përvoja e mëparshme:** Histori në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë ose fushatat e komunikimit.
4. **Angazhimi i komunitetit:** Praktika të dëshmuara për angazhimin e qytetarëve, OSHC-ve dhe grupeve të marginalizuara.
5. **Monitorimi dhe vlerësimi:** Kapaciteti bazë për të mbledhur të dhëna dhe nxjerrë mësim nga aktivitetet.

C. Kriteret e Diversitetit dhe Përfaqësimit

- Shtrirje gjeografike (veri/jug, bregdet/brendësi, urban/rural).
- Diversitet socio-ekonomik (bashki të mëdha dhe të vogla).
- Diversitet institucional dhe llojesh rreziku (tërmet, zjarre, përmbytje).
- Përfaqësimi kulturor dhe gjuhësor (përfshirë minoritetet).

D. Përshtatja me rolet e Kampionëve

Aplikantët duhet të konfirmojnë gatishmërinë për:

- Pjesëmarrje aktive në takimet për zhvillimin e Kuadrit Strategjik në Tiranë (2026-2028).
- Testimin e udhëzuesve dhe mjeteve në nivel lokal (2026–2028).
- Pjesëmarrjen pilote në aktivitete dhe Trajnimin e Trajnerëve (2027–2028).

E. Preferohet

- **Partneritetet:** Bashkëpunimi me OSHC-të, universitetet ose sektorin privat.
- **Inovacioni:** Ide praktike për komunikim digjital/inovativ.
- **Qëndrueshmëria:** Plani për integrimin e praktikave në buxhetet dhe qeverisjen e rregullt.

Procesi i përzgjedhjes dhe shpallja e fituesve

Procesi do të jetë transparent dhe i bazuar në parimet e qeverisjes së mirë:

- **Afati i aplikimeve:** 17 Mars 2026.
- **Vlerësimi i aplikimit:** 18- 19 Mars 2026.
- **Fituesit e fazes së parë:** 24 Mars 2026.
- **Përzgjedhja e fituesve faza e dytë:** 26 Mars 2026.
- **Shpallja e fituesve:** 27 Mars 2026.